



**Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania**

Fjalim nga

Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetar i Prezencës

Konferencë për Shtyp, 3 qershor 2003

Mirëmëngjes,

Do të deshiroja t'iu uroja mirëseardhjen përfaqësuesve të shtypit të pranishëm këtë mëngjes në selinë e Prezencës së OSBE-së. Unë do të nisem sot në Vienë për të paraqitur para 55 anëtarëve të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, ditën e enjte të kësaj jave, një prej raporteve periodike të Prezencës mbi aktivitetet tona dhe gjendjen në Shqipëri. Në vazhdim të politikës sime për të krijuar një Prezencë më transparente, ju ftova përsëri para nisjes sime për t'ju njohur me një pjesë të këtij raporti.

Raporti i fundit që mbajta para Këshillit të Përhershëm më 6 shkurt përqëndrohej në ridimensionimin e punës së Prezencës dhe në caktimin e përparësive të aktiviteteve të saj. Ky raport përqëndrohet në zhvillimet politike aktuale, përparimin e arritur në reformën zgjedhore, çështjen e pronave dhe debatin aktual mbi lirinë e medias, d.m.th. të gjitha çështjet që kanë lidhje me zgjedhjet e ardhshme vendore.

Që nga momenti kur termi “konsensus” u bë pjesë e pandashme e fjalorit të politikanëve, është e qartë se politika shqiptare po fillon të zhvillohet në një mënyrë të re. Shumë prej këtyre ndryshimeve kanë ardhur si pasojë e modernizimit të nevojshëm të Shqipërisë, kërkesë kjo e Procesit të Stabilizim Asociimit dhe procesit të integritimit në NATO.

Raporti ynë e përmend rezolutën e përbashkët të arritur së fundi nga Kuvendi në lidhje me raportin e Komisionit Evropian për Procesin e Stabilizim Asociimit si një shembull të shkëlqyer të formës së re të politikës së përgjegjshme. Kjo tregon se si angazhimi aktiv i opozitës në procesin politik duke përdorur zërin e saj në Kuvend ka pasur një ndikim të rëndësishëm në politikën dhe drejtimin e vendit dhe, gjithashtu, tregon se si institucionet e ndryshme shtetërore po fillojnë të përmbushin rolet e tyre kushtetuese për ekuilibrimin e njëri-tjetrit.

Megjithatë, zhvillimet politike pozitive të vërejtura nga Prezenca nuk çojnë domosdoshmërisht në rezultate të prekshme për popullsinë në përgjithësi dhe ka ende shumë punë për t'u bërë në aspektin e realizimit të reformave konkrete në sektorin gjyqësor dhe në luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje treguesve në ulje të ekonomisë dhe shqetësimit në rritje të komunitetit të biznesit.

Përfshirja e shpejtë e fushatës MJAF! në kulturën popullore brenda pak muajve të fundit është një shenjë që tregon se temat e tyre për cilësinë e jetës dhe qeverisjes kanë prekur telat e një pjese të shoqërisë të pakënaqur me natyrën pasive dhe shpesh të izoluar të politikës në këtë vend. Për këtë arsye, do të jetë interesante të shohim se sa të aftë do të jenë kandidatët e ardhshëm për kryetarë bashkish dhe komunash për t'iu përgjigjur shqetësimit të qytetarëve me afrimin e zgjedhjeve.

Reforma zgjedhore

Prezenca ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe lehtësimin e procesit të reformës zgjedhore gjatë vitit të kalur me rezultate të suksesshme. Pjesa më e madhe e këtij suksesi i dedikohet angazhimit të dy bashkëkryetarëve të Komisionit Dypalësh, përndryshe, procesi do të kishte dështuar kohë më parë, nëse nuk do të kishte qenë dëshira e qartë e dy partive kryesore politike për të arritur në një përfundim të kenaqshëm. Pas qëndrimit për disa netë me bashkëkryetarët deri pas mesnate, unë mund t'ju them se ata ishin negociatorë të rreptë. Megjithatë, ata ishin të hapur për dialog, gjë

qe çoi në rezultate pozitive. Amendamentet përfundimtare do të kalojnë në Parlament për miratim javën e ardhshme.

Reforma për Legjislacionin për Pronat

Pas diskutimeve të gjata me partitë politike, Prezenca ka prodhuar një plan pune për të lehtësuar debatin mbi ligjin për pronat në Parlament dhe do të do të krijojë një grup ekspertësh për të punuar me komisionet parlamentare për rishikimin e të dhënave mbi trojet ekzistuese dhe hartimin e një ligji realist dhe të kënaqshëm deri në fund të korrikut. Duke pasur parasysh natyrën politike të kësaj çështjeje, Prezenca do të jetë plotësisht e angazhuar në të njëjtën mënyrë siç ishte me Komisionin Dypalësh.

Liria e shtypit

Zgjedhjet vendore që po afrojnë i kanë dhënë më shumë rëndësi debatit aktual dhe të mirëpritur për lirinë e shtypit në Shqipëri. Mënyrat se si interesat e mediave në biznes ndërthuren me interesat e politikanëve dhe niveli i influencës që ushtrohet në media për të fituar avantazhe politike është një çështje që ngre shumë shqetësime. Mbështetja e fortë në reklamat që vijnë nga institucionet qeveritare, numri në rritje i proceseve gjyqësore për shpifje, apo kërcënimet për të hapur procese të tilla, po ashtu edhe veprime si moslejimi i gazetarëve për të ndjekur votimin në Parlament kanë rritur shqetësimin e Prezencës, e cila do të vazhdojë ta ndjekë këtë çështje nga afër.

Përfundime

Më lejoni ta mbyll kështu: Me rregullat e reja që drejtojnë procesin zgjedhor, që i japin partive mundësi të barabarta, zgjedhjet vendore do të jenë një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të mëtejshëm demokratik të Shqipërisë. Masa në të cilën partitë do të konkurrojnë duke paraqitur politika për të fituar vota dhe jo duke u mbështetur në rezultate të arritura nëpërmjet shfrytëzimit të mekanizmave institucionalë do të jetë një mjet për të treguar se sa ka përparuar ky zhvillim.